

VENDIM
Nr. 783, datë 12.12.2022

PËR NJË SHITESË NË VENDIMIN NR. 200, DATË 25.3.2021, TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE, “PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR
FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË OBJEKTEVE ARSIMORE NË
BASHKITË MIRDITË E KAMZË DHE CAKTIMIN E TYRE SI NJËSI ZBATUESE”,
TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit të Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, miratuar me ligjin nr. 97/2019, të ligjit nr. 9936 datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 115/2021, “Për buxhetin e vitit 2022”, të ndryshuar, me propozimin e zëvendëskryeministrit dhe ministër i Infrastrukturës dhe Energjisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 2/2, të vendimit nr. 200, datë 25.3.2021, të Këshillit të Ministrave, shtohet pika 2/3, me këtë përmbajtje:

“2/3. Përveç përcaktimeve të pikës 2/2, të këtij vendimi, përdorimin e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2022, në masën 29 438 505 (njëzet e nëntë milionë e katërqind e tridhjetë e tetë mijë e pesëqind e pesë) lekë pa TVSH, për financimin e rikonstruksionit të objekteve arsimore në Bashkinë Mirditë, të detajuar, si më poshtë vijon:

a) Rikonstruksion dhe sistem ngrohjeje i godinës nr. 3 (3 kate), shkolla 9-vjeçare “Pashko Vasa”, Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 14 859 730 (katërmëdhjetë milionë e tetëqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e shtatëqind e tridhjetë) lekë pa TVSH, në formën transfertës së pakushtëzuar;

b) Rikonstruksioni i kopshtit të fëmijëve (godina e vjetër) Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 4 216 892 (katër milionë e dyqind e gjashtëmbëdhjetë mijë e tetëqind e nëntëdhjetë e dy) lekë pa TVSH, në formën transfertës së pakushtëzuar;

c) Rikonstruksioni i kopshtit të fëmijëve me aftësi ndryshe (ish-godina e SHIK-ut) Rrëshen, Bashkia Mirditë, në masën 10 361 883 (dhjetë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e një mijë e tetëqind e tetëdhjetë e tre) lekë pa TVSH, në formën transfertës së pakushtëzuar.”

2. Ngarkohen Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, Ministria e Financave dhe Ekonomisë dhe Bashkia Mirditë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Belinda Balluku

